




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

THIRRJE PUBLIKE PËR KONKURS NË FOTOGRAFI DHE VIDEO

“Kamenica ndër vite”

Në kuadër të aktiviteteve të **Kamenica Summer Fest**, i cili promovon artin, kulturën, trashëgiminë dhe identitetin lokal përmes aktiviteteve të ndryshme kulturore e sportive, ftohen të gjithë fotografët, videografët, të rinjtë, mërgimtarët dhe qytetarët e interesuar të marrin pjesë në konkursin “**Kamenica ndër vite**”. Ky aktivitet synon të dokumentojë dhe promovojë historinë, zhvillimin, jetën kulturore, natyrën dhe kujtesën kolektive të Kamenicës përmes fotografive dhe videove.

Tema e konkursit

“**Kamenica ndër vite**” – fotografi dhe video që pasqyrojnë:

- Kamenicën e dikurshme dhe të sotme;
- Trashëgiminë kulturore dhe historike;
- Peizazhet natyrore;
- Jetën urbane dhe rurale;
- Ngjarjet, traditat dhe kujtimet e veçanta të qytetit dhe fshatrave të Komunës së Kamenicës.

Kushtet e pjesëmarrjes

- Konkursi është i hapur për të gjitha grupmoshat.
- Çdo pjesëmarrës mund të dorëzojë fotografi dhe video :
 - **fotografi**, dhe/ose
 - **video** me kohëzgjatje të pakufizuar .
- Materialet duhet të jenë origjinale dhe të realizuara nga vetë autori apo në pronësi të tij
- Fotografitë duhet të dërgohen kopje fizike ose në format JPG ose PNG, ndërsa videot në format MP4.

Vlerësimi

Punimet do të vlerësohen nga një komision profesional sipas kritereve:

- Kreativiteti dhe origjinaliteti;
- Vlera artistike;
- Cilësia teknike;
- Përputhshmëria me temën e konkursit.

Shpërblimet

- Vendi I – 500 €
- Vendi II – 300 €
- Vendi III – 200 €

(Nëse parashihen shpërblime ose mirënjohje të tjera, mund të shtohen.)

Afati i aplikimit

Punimet mund të dorëzohen deri më **10.7. 2026**, në adresën elektronike:

info.kamenica@rks-gov.net

ose në mënyre fizike në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë (QSHQ).

Ekspozimi i punimeve

Fotografitë dhe videot e përzgjedhura do të prezantohen gjatë aktiviteteve të **Kamenica Summer Fest**, ndërsa organizatori rezervon të drejtën e përdorimit të tyre për qëllime promovuese, duke cituar autorin.

Ruajmë kujtesën, promovojmë identitetin dhe tregojmë historinë e Kamenicës përmes artit vizual.

Mirë se vini të bëheni pjesë e konkursit “Kamenica ndër vite”!

Kamenicë, më 16.06.2026

Drejtori i DKRS


Afrim Dervshi